

RAPORT

POTENCIALET E BIZNESIT
NË BASHKINË DIBËR PËR TË OFRUAR
MUNDËSI PUNËSIMI PËR TË RINJTË

TFL
TOGETHER FOR LIFE

Raporti “Potencialet e biznesit në Bashkinë Dibër për të ofruar mundësi punësimi për të rinjtë” është zhvilluar nga shoqata “Together for Life”, në kuadër të projektit “Të luftojmë krimin e organizuar dhe mbështesim zhvillimin e të rinjve në Dibër”, mbështetur nga Nisma Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

Qëllimi është ngritja dhe fuqizimi i rrjetit midis studentëve dhe bizneseve lokale për të rritur shanset e të rinjve për t’u integruar në tregun e punës në rajonin ku ata jetojnë, përmjet ndjekjes së praktikave profesionale dhe punësimit në bizneset lokale.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e Together for Life dhe nuk reflekton dosmosdoshmërisht pikëpamjet e Nismës Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

Autor: © TOGETHER FOR LIFE
Rr. Brigada VIII, Pallati Jeshil –Tekno Projekt, Shk.2, Ap.14
Tiranë, Shqipëri
Email: info@togetherforlife.org.al
Web: www.togetherforlife.org.al

POTENCIALET E BIZNESIT NË BASHKINË DIBËR PËR TË OFRUAR MUNDËSI PUNËSIMI PËR TË RINJTË

Një nga problemet kryesore me të cilat po përballet rinia sot është pamundësia për t'u integruar në tregun e punës. Ky problem sjell edhe një sërë problemesh të tjera edhe më të mëdha, si gjenerimi i varfërisë nga brezi në brez, mungesa e perspektivës në vend për të rinjtë, rritjen e dëshirës së tyre për të emigruar me çdo mjet dhe në çdo mënyrë, madje edhe të paligjshme. Pjesa më e madhe e të rinjve që vazhdojnë të emigrojnë në mënyrë të paligjshme vijnë nga zona me varfëri më të madhe.

E tillë është edhe zona e Dibrës, një nga më të varfrat në vend, pavarësisht potencialit të madh që mbart për zhvillimin e ekonomisë dhe turizmit. Emigrimi i paligjshëm dhe dëshira për të dalë nga varfëria sa më shpejt i ka kthyer një pjesë të mirë të të rinjve në pre e lehtë e bandave kriminale jo vetëm në vend, por kudo në botë.

"Të rinjtë janë në rrezik dhe është koha kur të gjithë, shkolla, familja, shoqëria dhe çdo institucion, duhet të reagojnë dhe të ndërmarrin aksione konkrete për ndryshimin e situatës"

Projekti "*Të luftojmë krimin e organizuar dhe mbështesim zhvillimin e të rinjve në Dibër*", që po zbatohet nga shoqata "Together for Life" me mbështetjen financiare të "Nismës Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar", është fokusuar në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi rreziqet e krimit të organizuar, si dhe rolin dhe përgjegjësinë e aktorëve të tjerë, komuniteteve për të rritur lidhjen midis të rinjve dhe bizneseve lokale për mundësi më të mëdha punësimi.

Një nga qëllimet e projektit është ngritja dhe fuqizimi i rrjetit midis studentëve dhe bizneseve lokale për të rritur shanset e të rinjve për t'u integruar në tregun e punës në rajonin ku ata jetojnë, përmjet ndjekjes së praktikave profesionale dhe punësimit në bizneset lokale.

Projekti ka identifikuar rreth 50 biznese që ushtrojnë aktivitetin në bashkinë Dibër dhe janë të gatshëm të angazhohen në dhënien e mundësive për të rinjtë që të njihen me profilet e ndryshme të punës dhe kërkesat specifike për çdo profil, në mënyrë që pas mbarimit të arsimit të kenë mundësi të orientohen në treg bazuar në kërkesë-ofertë.
Informacioni që prezantohet në këtë dokument u është prezantuar të rinjve të përfshirë në Projekt, duke u ofruar informacion rreth rrugëve dhe mënyrave për sigurimin e një oferte pune, si dhe mundësive që ofron tregu i punës në zonën e Dibrës për ta, bazuar në aftësitë dhe preferencat individuale të çdo të riu.

Informacion i përgjithshëm për zonën

Dibra shtrihet në pjesën verilindore të Shqipërisë, në të dy anët e luginës së Drinit të Zi. Në lindje kufizohet me Republikën e Maqedonisë së Veriut, në veri me bashkinë e Kukësit, në veri-perëndim me bashkinë Mirditë, në perëndim me bashkinë Mat, në jug-perëndim me bashkinë Klos dhe në jug me bashkinë Bulqizën.

Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia e re ka një popullsi prej 61,619 banorësh, ndërkohë që sipas Regjistrit Civil kjo bashki numëron 78,940 banorë. Me një sipërfaqe prej 937.88 km2, kjo bashki përbëhet nga 15 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 141 fshatra. Relievi i bashkisë së re është përgjithësisht kodrinor dhe malor, por nuk mungon edhe ai fushor në të dyja anët e rrjedhjes së Lumit të Drinit të Zi, që favorizon kështu zhvillimin e bujqësisë dhe pemëtarisë. Bashkia e Dibrës është një nga bashkitë me territorin më të madh në rang vendi, si dhe me një numër të konsiderueshëm fshatrash të shtrira në një zonë të thellë. Dibra ka një sipërfaqe prej 1570 km dhe një popullsi prej rreth 78 mijë banorësh.

Relievi i bashkisë së re është përgjithësisht kodrinor dhe malor, por nuk mungon edhe ai fushor në të dyja anët e rrjedhjes së Lumit të Drinit të Zi, që favorizon kështu zhvillimin e bujqësisë dhe pemëtarisë. Përgjatë 25 viteve të fundit Dibra ka pasur një migrim të brendshëm drejt Tiranës dhe Durrësit, si dhe emigrim të konsiderueshëm jashtë vendit. Bashkia e Dibrës është aktualisht një nga zonat më të varfër të Shqipërisë, ku për një pjesë të madhe të popullsisë ndihma ekonomike e shpërndarë nga qeveria është burimi i vetëm i të ardhurave.

Bashkia Dibër ka plot resurse natyrore, por shfrytëzimi i tyre në dobi të turizmit dhe punësimit sezonal është akoma i ulët në hapat e para të saj. Zona e Dibrës ka potenciale të shumta për zhvillimin e turizmit malor dhe rural. Turizmi është sektori i dytë prioritar dhe me shumë potencial për zhvillimin e zonës të Dibrës. Potencialet e larta turistike, me burimet e shumta natyrore, vlerat e mëdha kulturore dhe historike, kulinarinë tradicionale e të pasur janë të pashfrytëzuara për turizmin.
Turizmi është një nga treguesit kryesorë për krijimin e vendeve të reja të punës, duke krijuar boshllëqe në fuqi punëtore të kualifikuar. Ruajtja dhe promovimi i bukurive natyrore, trashëgimisë kulturore, monumentet e natyrës duke i vënë në funksion për rritjet e turizmit do sigurojë mjaft të ardhura për banorët e zonës që presin turistët e huaj në bujtinat e tyre.
Me gjithë potencialin e madh për zhvillimin ekonomik të rajonit, kjo zonë vuan nga nivel i lartë papunësie, veçanërisht mes të rinjve.
Në Dibër gjatë vitit 2019, sipas të dhënave zyrtare, papunësia u dyfishua në raport me një vit më parë, duke arritur në 12.4 për qind në tremujorin e dytë në raport me 5.3 për qind që ishte tre-mujorin e dytë të vitit 2018.
Niveli i papunësisë tek të rinjtë është më i lartë, mbi 2 herë më i lartë nga papunësia mesatare. Shkalla e punësimit shkon në 45.4% në Dibër, por më shumë se gjysma (59%) e të punësuarve e përbëjnë të punësuar në bujqësi dhe vetëm 13% në industri dhe 27% në shërbime.
Papunësia ndër të rinjtë është një problem i mprehtë i ekonomisë së tranzicionit, por kërkesa për punë nga të rinjtë, vitet e fundit ka ardhur në rënie, pasi shumë të rinj i janë drejtuar tregut ndërkombëtar, nëpërmjet kontratave të përhershme ose sezonale. Emigracioni tek të rinjtë është shumë i lartë dhe nuk është ulur me vitet, përkundrazi.

Papunësia tek të rinjtë shënoi rritje të dukshme në tremujorin e dytë të vitit 2020, për shkak të shkurtimit të personelit në sektorin e shërbimeve, hoteleve, bareve, restoranteve dhe fabrikave si pasojë e pandemisë.

Nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësimit mësohet se shkaku kryesor i rritjes së papunësisë ndër të rinjtë është mungesa e ofertës për punë. Sipas Zyrës Rajonale të Punësimit Dibër, ofertat e biznesit për punëkërkuesit e papunë janë kryesisht për punëtorë krahu ose punonjës të pakualifikuar. Në pozicionet kyçe të biznesit, si menaxher, ekonomist, inxhinier, përgjegjës, etj, sipërmarrësit zgjedhin të vendosin të afërmit e tyre.

Ndikimi në punësim i pandemisë COVID-19

Sipas të dhënave të INSTAT, shkurtimet më të mëdha nga puna gjatë pandemisë janë aplikuar nga sektori i bareve dhe restoranteve, ku raportohet rënie e indeksit të punësimit me 31.8%, pasuar nga hotelet me -20.2% dhe fabrikat me -12.8%. Rënie të punësimit shënuan edhe disa linja të tjera shërbimesh, të tilla si aktivitetet inxhinierike me -2.5%, informacioni dhe komunikimi me -2.3%, tregtia dhe riparimi i automjeteve me -2.2% dhe agjencitë e udhëtimit me -2.1%.

Në disa linja të sektorit të prodhimit tregu i punës nuk është ndikuar nga pandemia. Furnizimi me ujë dhe përpunimi i mbetjeve shënoi rritje të punësimit me 4.6 për qind në raport me tremujorin e dytë të vitit. Kjo rritje duket se është nxitur nga punësimi në ndërmarrjet shtetërore të ujësjellësit, pasi pjesa dërrmuese e tyre janë në pronësi publike.

Sektori i ndërtimit gjithashtu shënoi rritje vjetore me 1.9 për qind gjatë pandemisë në tremujorin e dytë. Sektori nuk e ndaloi aktivitetin as gjatë masave kufizuese, teksa nisja e procesit të rindërtimit në zonat e dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 duket se ka nxitur punësimin në ndërtim. Rritje të punësimit ka pasur edhe sektori i energjisë elektrike me rreth 1.2 për qind. Prodhimi i energjisë elektrike nuk është prekur nga kriza teksa rritja e punësimit është nxitur nga investimet gjithnjë e në rritje në ndërtimin e HEC-ve.

Edhe bizneset në Dibër kanë pësuar rënie të ardhurash dhe ulje punësimi gjatë periudhës së pandemisë. Sektori minierave është më i madhi në Dibër dhe, nga të dhënat e fundit, 38 galeri kromi në rrethet Bulqizë, Mat e Dibër u mbyllën muajit e fundit për shkak të mungesës së tregut të shitjes së mineralit, duke lënë të papunë 680 punëmarrës. 35 subjekte të tjera po punojnë me kapacitet të reduktuar.
Sipas Zyrës Rajonale të Punësimit Dibër, në këtë periudhë ka rënë numri i ofertave të punës nga ana e bizneseve të cilat 'nuk guxojnë' të shpenzojnë për fuqi të re punëtore. Po ashtu, ndryshimet ligjore që heqin detyrimin e bizneseve për të deklaruar çdo vend të ri pune pranë zyrave të punës, ka ulur interesin e biznesit për të shpallur paraprakisht vendet e reja të punës nëpërmjet zyrave të punës.

Politikat shtetërore për nxitjen e punësimit

Me ndryshimet e fundit të ligjit për Nxitjen e Punësimit është parashikuar mbështetja jo vetëm e punëdhënësve për hapjen e vendeve të reja të punës, por edhe të vetë të papunëve për të krijuar biznese

që u mundësojnë vetëpunësimin. Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, në kuadër të Programeve të Nxitjes së Punësimit, filloi këtë vit zbatimin e Programit të Vetëpunësimit. AKPA, nëpërmjet zyrave të punës, sapo ka shpallur fazën e parë të thirrjes në të cilën fton të gjithë punëkërkuesit e papunë të regjistruar në Zyrat Vendore te Punësimit, të cilët kanë një ide biznesi, të marrin pjesë në konkurrimin për mbështetje nga fondet buxhetore për hapjen e bizneseve të reja që mundësojnë punësim dhe vetëpunësim. Kjo fazë po pilotohet në 4 rajone, me një numër të kufizuar përfituesish (rreth 50 punëkërkues të papunë), në Tiranë 30 (tridhjetë), Shkodër 10 (dhjetë), Kukës 5 (pesë) dhe Dibër 5 (pesë). Programi i vetëpunësimit është program njëvjeçar për mbështetjen e sipërmarrjeve të reja, nëpërmjet të cilit ofrohet trajnim për sipërmarrjen dhe zhvillimin e planeve të biznesit për aplikuesit dhe grant për përfituesit.
Programi i Vetëpunësimit mbështet punëkërkuesit e papunë, të regjistruar në zyrat e punës, që kanë dëshirën dhe vizionin për të ndërtuar biznesin e tyre. Nëpërmjet trajnimit mbi vetëpunësimin, këshillimeve të vazhdueshme gjatë gjithë fazave të programit, dhe mbështetjes financiare (në formën e pajisjeve dhe / ose materialeve), programi asiston në transformimin e ideve në biznese të qëndrueshme.
Të gjithë personat të cilët janë të përfshirë në program do të përfitojnë:
(1)Trajnime për zhvillimin e planit të biznesit dhe njohjen e koncepteve bazë të lidhur me vetëpunësimit;
(2) Mbështetje financiare për blerjen e pajisjeve dhe / ose materialeve deri në vlerën 500,000 Lekë**.**

Kush mund të aplikojë?

Për të aplikuar në këtë program, aplikuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
a) Është punëkërkues i papunë i regjistruar në strukturën vendore të punësimit;
b) Ka një ide biznesi, e cila nuk është në kundërshtim me kriteret e konkurrueshmërisë;
c) Punëkërkuesi, i cili aplikon në këtë program, duhet të marrë pjesë personalisht në të gjitha hallkat e procesit.

Çfarë subvencionon programi?
Programi i Vetëpunësimit subvencionon për të gjithë të përzgjedhurit si përfitues i grantit për ngritjen e biznesit deri në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për të mbuluar shpenzimet për hapjen e biznesit. Shpenzimet që nuk mund të mbulohen nga granti i financuar janë:
a) blerja e pasurive të patundshme;
b) çdo shpenzim që nuk lidhet dhe nuk përfshihet në planin e biznesit të miratuar;
c) shpenzimet e kryera përpara nënshkrimit të marrëveshjes së grantit;
ç) pagat, shpërblimet, qiraja dhe shpenzimet e tjera administrative.

Si aplikohet?
Aplikimi bëhet nëpërmjet dorëzimit në të gjitha zyrat e punës në rajonet e Tiranës, Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës deri në datën 15.12.2020.

Akpa aplikon edhe programe nxitje punësimi, nëpërmjet të cilave ofron mbështetje për bizneset që hapin vende të reja pune. Bizneset mbështeten me fonde që mbulojnë sigurimet shoqërore dhe një pjesë të pagave të punëmarrësve. Sipas Zyrës së Punës Dibër, gjatë këtij viti (2020) bizneset në këtë rajon nuk janë të interesuara të aplikojnë për këtë fond, pasi planet e tyre të rritjes, që sjell edhe punësime të reja, kanë stopuar si pasojë e pasigurisë së krijuar nga pandemia.

Bashkia Dibër për herë të parë me Plan Lokal të Veprimit për Rininë

Bashkia Dibër, me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert, në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar, ka hartuar para një viti, për herë të parë Planin Lokal te Veprimit për Rininë, ku prezantohen përpjekjet për të ndërhyrë thellë e në mënyrë gjithëpërfshirëse për transformimin e realitetit ku jetojnë, studiojnë dhe ëndërrojnë të rinjtë e bashkisë. Ky plan vendos si prioritet përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimin e statusit të tyre, përmes zhvillimit të më shumë mundësive në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe rritjen e pjesëmarrjes së plotë të të rinjve në shoqëri dhe vendimmarrje.
Plani Lokal adreson papunësinë e të rinjve (duke përfshirë sidomos angazhimet sezonale ose studentore), efektshmërinë dhe zbatueshmërinë e politikave që janë në fuqi, vetëpërfshirjen e të rinjve dhe palëve të treta në organizata të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare e më tej.

Mbështetja për të rinjtë e shkollave të mesme në Dibër

Sipas të dhënave të Bashkisë Dibër, në këtë rreth janë rreth 10 500 të rinj, të cilët studiojnë në 8 shkollat e mesme dhe 1 profesionale. Në shumicën e shkollave mungojnë laboratorët cilësorë për zhvillimin e orëve informatikë-kimi-fizik-biologji, ku nxënësit mund të ushtrojnë dhe praktikojnë njohuritë e tyre. Edhe në shkollën profesionale të qytetit në laboratorët e IT kompjuterët janë tepër të vjetër. Këto mungesa ndikojnë negativisht në mësimdhënie dhe në zhvillimin arsimor dhe profesional të të rinjve. Programet e shkëmbimit midis shkollave janë thuajse inekzistente. Mungojnë projekte dhe programe që të mbështesin vizita studimore, shkëmbime, eksperiencë ose pjesëmarrje/realizime konkursesh të të rinjve midis shkollave në nivel qarku ose kombëtar. 1
UNICEF Shqipëri, në kuadër të një programi për të rinjtë e shpëtuar nga trafikimi dhe në rrezik trafikimi që po zbaton në disa nga rajonet e vendit, ka mbështetur Shkollën Profesionale Publike "Nazmi Rrushiti" në Dibër me pajisje për të operuar online si dhe trajnime IT. Pajisjet elektronike janë të domosdoshme për një shkollë profesionale që ka edhe degë TIK, megjithatë as kjo ndërhyrje nuk i plotëson nevojat e nxënësve të degës IT të kësaj shkolle. E vënë në dijeni nga drejtuesit, mësuesit dhe nxënësit e shkollës 'Nazmi Rushiti" rreth nevojës për të pasur pajisje elektronike / kompjuterë bashkëkohorë për zhvillimin normal të mësimit në laboratorët e IT, Projekti që po zbatohet nga TFL do të dhurojë kompjuterë për laboratorët e IT me qëllim kryerjen sa më të mirë të procesit mësimor.
Gjatë vizitave studimore që të rinjtë e shkollave të mesme të qytetit të Peshkopisë zhvilluan në sipërmarrjet më të suksesshme të zonës, sipërmarrësit treguan gatishmëri që t'i pranojnë për të kryer praktika profesionale, me qëllim rritjen e aftësive të tyre në procese pune të caktuara.

Zhvillimi i sipërmarrjes në Dibër, shpresë për punësimin e të rinjve

[1] https://www.fes-tirana.org/fileadmin/user_upload/documents/Plani_lokal_i_veprimit_per_rinine_2020-2023_Diber.pdf

Pjesa më e madhe e të rinjve në Dibër shohin si mundësi punësimi migrimin e brendshëm, në Tiranë, Durrës, apo qytete të të tjera të mëdha, ose emigrimin jashtë vendit. Edhe pse një zonë me potenciale të mëdha zhvillimi ekonomik, si industrial ashtu edhe turistik, ende Dibra mbetet një nga zonat më të varfra të vendit. Sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2019, rezulton se në Dibër janë 1289 biznese aktive, mbi 90% e të cilave janë biznese të vogla me nga 1 deri në 9 të punësuar. Vetëm 69 biznese, po sipas INSTAT, kanë të punësuar 10 ose më shumë punëmarrës. Bizneset e vogla janë më së shumti biznese familjare, në të cilat janë të punësuar anëtarët e familjes dhe nuk ofrojnë mundësi punësimi për të tjerë. Bizneset e vogla janë në fushën e shërbimeve, bar restoranteve, hoteleri, njësi të vogla shitblerjeje, etj.
Disa prej bizneseve të identifikuara nga projekti gjatë implementimit të tij, të cilat veprojnë në zonën urbane, ose pranë zonës urbane të bashkisë Dibër, gjenden në tabelën më poshtë.

Nr	LLOJI I BIZNESIT	BIZNESI
1	HOTELERI	Bujtina e Jufkave
2		Hotel Veri
3		Hotel Xhariu
4		Hotel Piazza
5		Hotel Natyra e Qetë
6		Hotel Ballkan
7		Hotel Reçi
8		Royal Hotel
9		Zerja Hotel
10		Hotel Kristal
11		Ensol B&B
12		Hotel Termal
13		Hotel Korabi
14		Brooklen Hotel
15		Guest House Sabriu
16		Peshkopia Backpaker Hostel
17		Hotel Ergoni
18		Hoteli i Llixhave Klajdi
19		Hotel Brazil
20		Konaku Dibër
21		Bujtina Konaku
22		Doda Hotel
23		Hotel Luani
24		Hotel Bilbili
25		Hotel “Kurora e Gjelbër”
26		Hotel Manga

	RESTORANT	
1		Restorant Qendra
2		Bar Restorant MIKU
3		Banket New York Buffet
4		Bar Restorant Oxhaku
5		Restorant Ardero
6		Vranici's Grill
7		Restorant Qendra
8		Pasticeri Mena
9		Restorant Zhuzhi
10		Restorant 'Turizmi i Vjetër'
11		Restorant Vila Rama
12		Restorant Besi
13		Restorant N. Lusha
14		Restorant Miel de Luna
15		Restorant Vëllezërit Çenga
16		Eltokido Pizza Delivery
17		Restorant M. Zebi
18		Restorant Kica
	BAR KAFE	
1		Bar-Kafe Bali
2		Bar-Kafe Besatari
3		Bar-Kafe Rotullimi
4		Bar-Kafe Shira
5		Bar-Kafe Elisabeta
6		Bar-Kafe Meta
7		Don Caffe Bar Lounge
8		Bar-Kafe Viktor
9		Bar-Kafe Baria
10		Bar-Kafe Riku
11		Bar-Kafe Cena
12		Bar-Kafe Sosa
13		Bar-Kafe Kaba
14		Vranici Street House Caffee Bar
	NJËSI TË TJERA SHËRBIMI	
1		Batting Tip Shopping Mall
2		Eiba Shopping Center
3		Supermarket Çenga
4		Shoping Mall

5		Supermarket Makishti
6		Furre Buke Balliu
7		Rrobaqepsi Lina
8		Lavazh Geri
9		Auto Servis Vëllezërit Mazari
10		Auto Servis Uka
11		Auto Servis Reçi
12		Materiale ndertimi Shulku
13		Mobileri Vëllezërit Miftari
14		Hidrosanitare Cemali
15		Butik Gjadri
16		Vëllezërit Kurti
17		Mobileri Vëllezërit Miftari
18		Mobileri Reçi
	FABRIKA	
1		'Koop frut 2000' – përpunim frutash
2		Fabrika e Qumshtit 'Ngota'
3		Punishtja e frutave dhe prodhimit të frutave 'Zerja'
4		'Kaza Frut Dibër"
5		Fabrika e miellit 'Rifidi'
6		Prodhime brumi - Balliu Di
7		Prodhime brumi - Liman Mazari
8		Fabrika e miellit SPATA Blliçe

Të rinjtë zhvilluan vizita studimore në disa nga këto biznese, 6 prej të cilave përshkruhen më poshtë.

1- **Fabrika e Qumështit 'NGOTA"**

Punishtja është hapur në 2010 dhe në atë kohë përpunonte 3 kuintalë qumësht në ditë. Pas 10 vitesh kapaciteti i saj është rritur dhe ajo sot përpunon 10 ton qumësht në ditë dhe ka lidhur kontratë për grumbullimin e qumështit me rreth 200 fermerë të zonës së Dibrës.
Fabrika prodhon të gjitha produktet e qumështit bazuar në teknologjinë më të fundit. Djathi, gjalpi, gjiza, kosi dhe qumështi nën logon 'NGOTA" ka gjetur treg në të gjithë vendin, veçanërisht në Tiranë. Kjo fabrikë ofron mundësi punësimi për punonjës të ndryshëm, që nga ata të pakualifikuarit, deri tek punonjësit e mesëm të kualifikuar, apo me arsim të lartë teknologjik.

2- **Kop.Frut Dibër 2012**

Kop.Frut Dibër është një koperim mes kompanisë dhe prodhuesve Dibran. Qëllimi i Kop.Frut Dibër 2012 është grumbullimi, ruajtja dhe përpunimi i frutave. Ajo synon të kthej traditën dibrane të kultivimit të pemëve frutore si molla, dardha, ftoi, qershia etj.

Kop.Frut Dibër 2012 u formua në Maj te vitit 2012 mes dy ortakëve z. Vehip Salkurti dhe z. Namik Shehi. Si fillim nisën me ndërtimin e katër dhomave frigoriferike (freskuese) me kapacitet rreth 480 ton. Sot fabrika ka një kapacitet përpunues prej 8 ton të ditë lëng frutash të freskët. Fabrika punon me teknologji të përparuar. Lëngjet e prodhuara prej saj gjenden sot në të gjithë vendin. Ato janë lëngje 100 natyrale dhe për prodhimin dhe ruajtjen e tyre nuk përdoren as sheqerna, as konservantë dhe as ngjyrues, duke siguruar kështu vlerat e plota të frutave të përpunuara në këtë fabrikë. Kjo sipërmarrje është një nga krenaritë e Dibrës. Ajo është një mundësi e mirë punësimi veçanërisht për të rinjtë e diplomuar ose jo. Kjo fabrikë ka të punësuar të përhershëm 5 punonjës, por gjatë sezonit numri i të punësuarve është disa herë më i lartë. Por, numri i përfituesve është shumë më i lartë, pasi janë mbi 100 fermerë dibranë e furnizojnë fabrikën me lëndën e parë, mollët e të gjitha varieteteve.

3- Bujtina e Jufkave

Në vitin 2008, familja Zerja filloi prodhimin dhe shitjen e trahanasë, e cila bëhet nga brumë i thartuar me miell dhe kos, si dhe jufka, makarona tradicionale të zonës. Edhe pse kjo sipërmarrje nisi fillimisht si një biznes anësor për të sjellë disa të ardhura shtesë për familjen, përqendrimi te cilësia dhe metodat tradicionale të prodhimit, shumë shpejt i bëri "Jufkat Zerja" të njohur edhe jashtë zonës së Dibrës. Vit pas viti u shtuan edhe produktet, duke filluar nga reçelnat dhe kompostot me fruta vendi, tek turshitë, apo lëngjet e larmishme.
Prej 1 viti familja Zerja e ka zgjeruar biznesin dhe ka hapur edhe një bujtinë në të cilën ofrohet ushqim tradicional i zonës dhe akomodim për vizitorët nga vendi dhe jashtë tij. Me zgjerimin e sipërmarrjes nga familja Zerja, është rritur numri i të punësuarve, kryesisht banorë të zonës. Ky biznes është një model shumë i mirë për zhvillimin dhe promovimin e turizmit në këtë zonë, por edhe një mundësi punësimi për të rinjtë e zonës.

4- 'Kaza Frut Dibër"

Në vitin 2008, Ramazan Kaza përuroi linjën e frutave të thata "Kaza frut Dibër". Zona e Dibrës njihet për frutat cilësore dhe tepër të shijshme si molla, kumbulla, qershia, dardha, etj. Çdo vit fabrika përpunon rreth 500 kuintalë kumbull të freskët. Janë me dhjetëra fermerët që përfitojnë nga kjo sipërmarrje. Pas certifikimit ndërkombëtar të produkteve frutat e thata të Dibrës tashmë kanë gjetur edhe tregun ndërkombëtar. Kjo sipërmarrje është një mundësi shumë e mirë për fermerët e rinj që të rrisin sipërfaqen e mbjelljes me drufrutorë dhe të të gjejnë treg për produktet e tyre.

5 - Fabrika e miellit SPATA Blliçe

Fabrika SPATA Blliçe është prodhuesi kryesor i miellit të grurit në rajonin e Dibrës. Duke qenë përbërës kaq i rëndësishëm i ushqimit të përditshëm, kualiteti është faktor krucial në përzgjedhjen e tij. Prandaj, Fabrika Spata vazhdon të prodhoj miell kualitativ për konsumatorët e tij besnik për vite të shumta radhazi. Fabrika Spata punëson 10 punëtorë që angazhohen për përmbushje të nevojave unike të konsumatorëve dhe fermerëve.
Me kapacitet ditor të prodhimit prej 120 ton të prodhuar sipas standardeve, Fabrika Spata është njëra nga fabrikat më serioze të prodhimit të miellit në Rajon.

6 – Furra e bukës dhe ëmbëlsirave Balliu Di

Furra më e njohur e bukës në Peshkopi është Balliu Di. Furra e bukës Balliu ofron për klientët e saj më shumë se 7 lloje bukësh. Kjo furrë është furnizuesi kryesor i restoranteve dhe dyqaneve në Dibër, jo vetëm me bukë, por edhe me produkte të tjera brumi, përfshi edhe ëmbëlsirat. Balliu Di prodhon

ëmbëlsira tradicionale. Të gjitha nënproduktet e furrës Balliu prodhohen me lëndë të parë 100% BIO dhe pa asnjë konservim.

Vende pune potenciale për të rinjtë në rajonin e dibrës

Në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Punësimit dhe me bizneset që veprojnë në bashkinë e Dibrës, Projekti përgatiti profilet më poshtë për pozicionet e punës që ofrohen më shumë nga bizneset që veprojnë në Dibër për punëkërkuesit e interesuar.
Këto pozicione pune ofrohen nga bizneset ose nëpërmjet shpalljes në zyrën e punës, ose nëpërmjet njoftimeve në portalet e vetë bizneseve.

LABORANT USHQIMOR	
Bizneset	**Fabrikat ushqimore**
Sasia e vendeve të lira të punës	
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	***Me afat të pacaktuar***
Koha e punës	**Me kohë të plotë**
Paga	
Nga	**50 000**
Deri	**60 000**
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	**Arsim i mesëm (Profesional/I orientuar)**
Niveli i kualifikimit	**Niveli 5**
Eksperienca në punë	**Po**
Përshkrimi i eksperiencës	**Duhet të keni të paktën 2 vjet përvojë pune.**
Përgjegjësitë	- Të përgatisë receptura të ndryshme në varësi të llojit të produktit, recetës dhe kartës teknologjike; - Të kryejë matje dhe kontrolle të karakteristikave teknologjike të lëndëve të para, produkteve të ndërmjetme, produkteve të gatshme, ambalazheve dhe të parametrave teknologjike gjatë proceseve të ndryshme të përpunimit të frutave dhe perimeve; - Të marrë mostrat sipas llojit dhe konsistencës së produktit dhe sipas rregullave dhe udhëzimeve për kontrollin e ecurisë së punës gjatë prodhimit të konservave të frutave dhe perimeve; - Të përgatisë lëndët e para, lëndët ndihmëse dhe shtesat e ndryshme, në varësi të llojit të produktit që do të prodhohet dhe kërkesave kryesore standarde; - Të përgatisë konservantë të ndryshëm që përdoren në teknologjinë e përpunimit të frutave dhe perimeve, duke zbatuar rreptësishtë normat standarde të lejuara;

	- Të kryejë pasterizimin e lëngjeve të frutave dhe perimeve, konservave me pH më të ulët se 4.5, konservave me përmbajtje të lartë kripe dhe sheqeri; - Të kryejë sterilizimin e konservave me pH mbi 4.5, konservave me përmbajtje të ulët kripe dhe sheqeri duke zbatuar formulën e sterilizimit; - Të kryejë procese të përpunimit të mbetjeve teknologjike;

KONSERVUES FRUTASH	
Bizneset	Fabrika frutash
Sasia e vendeve të lira të punës	5
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat të pacaktuar
Koha e punës	Me kohë të plotë
Paga	
Nga	27000
Deri	30000
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm i lartë (Gjimnaz)
Niveli i kualifikimit	Niveli 2
Eksperienca në punë	Jo
Përgjegjësitë	Të kryejë procese të higjienizimit të vendit të punës, mjeteve, pajisjeve, makinerive dhe linjave të automatizuara; - Të kontrollojë gatishmërinë dhe funksionimin e makinerive dhe pajisjeve, para dhe gjatë proceseve të ndryshme të prodhimit të konservave të ndryshme të frutave dhe perimeve; - Të përgatisë lëndët e para, lëndët ndihmëse dhe shtesat e ndryshme, në varësi të llojit të produktit që do të prodhohet dhe kërkesave kryesore standarde; - Të kryejë proceset përgatitore për përpunimin e frutave dhe perimeve; - Të kryejë mbushjen e ambalazheve me fruta apo perime të përgatitura dhe të përpunuara duke zbatuar kërkesat standarde; - Të realizojë procesin e etiketimit, magazinimit dhe ruajtjes së frutave dhe perimeve të freskëta dhe të përpunuara sipas kushteve teknike dhe kërkesave standarde për ruajtjen dhe magazinimin e tyre; - Të identifikojë defektet gjatë prodhimit dhe ruajtjes së produkteve të prodhuara; - Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të mbrojtjes së mjedisit, gjatë përpunimit të frutave dhe perimeve;

Aftësitë	• Të kenë nivel të lartë të higjienës • Të kenë qëndrueshmëri dhe forcë fizike • Të kenë njohuri në operimin e makinave • Të kenë njohuri për frutat dhe perimet

PUNËTOR KRAHU NË FABRIKË	
Bizneset	Fabrika
Sasia e vendeve të lira të punës	10
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat të caktuar
Koha e punës	Me kohë të plotë
Paga	
Nga	
Deri	
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm i ulët (9-vjeçar)
Niveli i kualifikimit	Niveli 1
Eksperienca në punë	Jo
Përshkrimi i eksperiencës	
Përshkrimi i vendit të punës	Pozicioni Punës: Pastrues peshku Si Aplikohet: Të paraqitet pranë Zyrave të Punës

SHOFER FURGONI MALLRASH	
Bizneset	Fabrika
Sasia e vendeve të lira të punës	3
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat të pacaktuar
Koha e punës	Me kohë të plotë
Paga	
Nga	45000
Deri	48000
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm i lartë (Gjimnaz)
Niveli i kualifikimit	Niveli 4
Eksperienca në punë	Po
Përgjegjësitë	- Zbaton urdhrat e eprorit të drejtpërdrejtë për destinacionet dhe punën specifike; - Zbaton në kohë dhe me cilësi të lartë detyrat që i janë ngarkuar; - Kryen punë të përfshira në detyrat e tij ose të besuara nga administrate; - Është përgjegjës për transportit e sigurt të mallit;

	- Merr dhe dorëzon mallin kundrejt faturave; - Raporton për çdo problem që shkakton vonesa, apo dëmtim të cilësisë së mallit; - Zbaton me korrektësi rregullat e qarkullit rrugor; - Kujdeset për mjetin duke i kryer në kohë të gjitha shërbimet; - Mirëmban dokumentacionin e kërkuar nga ligjet dhe rregulloret në fuqi.
Aftësitë	- Disponon patentë për drejtim automjeti të nivelit të kërkuar; - Ka dëshirën për të punuar; - Është i gatshëm të punojë në orare fleksible. - Është i përgjegjshëm dhe i ndërgjeshëm në kryerjen e detyrës.

NËPUNËS MAGAZINE	
Bizneset	Fabrika
Sasia e vendeve të lira të punës	2
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat të pacaktuar
Koha e punës	Me kohë të plotë
Paga	
Nga	35000
Deri	41000
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm i ulët (9-vjeçar)
Niveli i kualifikimit	Niveli 3
Eksperienca në punë	Jo
Përgjegjësitë kryesore	• Është përgjegjës për vendosjen, sistemimin dhe administrimin e gjithë materialeve që ndodhen në magazinë. • Bën inventarizimin e materialeve, dokumenton çdo lëvizje në magazinë (hyrje ose dalje), si dhe transferon materiale të kompanisë sipas një kërkese të aprovuar nga administratorja e kompanisë. • Është përgjegjës për ruajtjen e vlerave materiale sipas kushteve teknike që kërkon secili prej tyre. • Është përgjegjës për rregullsinë dhe ligjshmërinë e plotësimit të të gjithë dokumentacionit të hyrjes (marrjes në dorëzim) apo daljes (dorëzimit) të materialeve, si fletëhyrje, fletëdalje, procesverbale etj. • Mbikëqyr aktivitetin dhe shpërndan detyrat për punëtorët e magazinës. • Plotëson ditarin e magazinës për çdo lëvizje, hyrje-dalje dhe dokumentet dhe kartelat përkatëse. • Mban procesverbale për çdo incident, thyerje, dëmtim

	apo shpërdorim. • Mban inventarin e gjendjes së mallit në magazinë dhe përgatit raporte. • Bën raportime ditore tek eprori i drejtpërdrejtë. • Është përgjegjës të performojë detyra të tjera që kërkohen nga eprori i drejtpërdrejtë.
Aftësitë bazë	• Aftësi shumë të mira organizuese dhe koordinuese. • Aftësi për të dhënë sugjerime dhe alternativa për zgjidhjen e problemeve dhe situatave. • Aftësi të mira komunikimi dhe të bashkëpunimit. • Të jetë i besueshëm, i përgjegjshëm dhe të përmbushë detyrimet e punës.

PUNËTOR PAKETIMI	
Bizneset	Fabrika
Sasia e vendeve të lira të punës	6
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat te pacaktuar
Koha e punës	Me kohe te plote
Paga	
Nga	27000
Deri	30000
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm i lartë (Gjimnaz)
Niveli i kualifikimit	Niveli 2
Eksperienca në punë	Jo
Përgjegjësitë kryesore	• Të njohë dhe respektojë rregullat për paketimin e produkteve; • Të njohë dhe respektojë kushtet teknike dhe standardet për produktet e paketuara dhe me dozë; • Të njohë dhe respektojë rregullat për stivosjen, mbështjelljen, fiksimin në kontejnerë dhe paketimin e produkteve të mëdha dhe të rënda të përfunduara; • Të njohë cilësitë e produkteve që paketohen dhe karakteristikat specifike të tyre; • Paketimi produkteve sipas specifikimeve teknike.
Aftësitë bazë	• Të jetë i gatshëm të respektojë orarin e punës • Të jetë i motivuar • Të gëzojë shëndet të plotë

BANAKIER	
Bizneset	Njësi shërbimi - bar

Sasia e vendeve të lira të punës	2
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat të pacaktuar
Koha e punës	Me kohë të plotë
Paga	
Nga	
Deri	
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm (Profesional/I orientuar)
Niveli i kualifikimit	Niveli 5
Eksperienca në punë	Jo
Përgjegjësitë kryesore	• Përgjegjës/e për mbulimin e të gjithë procesit të punës në banak; • Përgjegjës/e për realizimin e kërkesave të klientëve në kohë dhe me cilësi maksimale; • Përgjegjës/e për përgatitjen dhe paraqitjen e pijeve në mënyrë sa më tërheqëse për klientelen; • Përgjegjës/e të sigurojë mirëmbajtjen dhe higjienën maksimale në banak;
Aftësitë bazë Aftësitë	• Të jetë korrekt/e dhe disponibël; • Të ketë komunikim të mirë me klientët dhe stafin e punës; • Të ketë përkushtim maksimal gjatë orarit të punës; • Të jetë i/e motivuar dhe energjik/e;

KAMARIER	
Bizneset	Njësi shërbimi – bar-restorant
Sasia e vendeve të lira të punës	3
Rrethi	Dibër
Njësia administrative	Dibër
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat te pacaktuar
Koha e punës	Me kohë të plotë
Paga	
Nga	
Deri	
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm (Gjimnaz)
Niveli i kualifikimit	Niveli 4
Eksperienca në punë	Jo

Përgjegjësitë kryesore	1. Merr porosinë klientëve dhe i shërben atyre. 2. Kujdeset për gjendjen higjienike personale, mjeteve, gjërave konsumuese, lokalit. 3. Shfrytëzon në mënyrë të kujdesshme dhe racionale mjetet dhe gjërat tjera me të cilat disponon 5. Respekton orarin e punës dhe orarin e shërbimit. 6. Duhet të jetë profesional, me përvojë, i besueshëm si dhe i aftë që t'i kryejë në mënyrë profesionale detyrat e dhëna brenda një periudhës së pranueshme kohore.
Aftësitë	• Duhet të jetë i shkathët • Duhet të përdor maturinë gjatë punës me njerëz dhe detyrën. • Duhet të jetë i motivuar dhe të ketë etik të fort pune.

PRODHUES TË FRUTAVE TË SHEQEROSURA	
Bizneset	Fabrika
Sasia e vendeve të lira të punës	10
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat te caktuar
Koha e punës	Me kohë të plotë
Paga	
Nga	
Deri	
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm (Gjimnaz)
Niveli i kualifikimit	Niveli 2
Eksperienca në punë	Jo
Përgjegjësitë	• Të ketë njohuri për cilësitë e frutave; • Të njohë në teori dhe praktikë mënyrën e përpunimit të frutave pa humbur vlerat e tyre; • Të dijë të bëjë klasifikimin dhe paketimin e frutave • Të pastrojë, grimcojë frutat për t'i përgatitur për përpunim • Të pastrojë makineritë / veglat • Të paketojë produktet
Aftësitë	• Të ketë nivel të lartë të higjienës • Të ketë qëndrueshmëri dhe forcë fizike • Të ketë njohuri në operimin e makinave • Të ketë njohuri për frutat dhe perimet

TEKNOLOG USHQIMOR	
Bizneset	Fabrika
Sasia e vendeve të lira të punës	6
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat të pacaktuar
Koha e punës	Me kohë të plotë
Paga	
Nga	50000
Deri	56000
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i lartë (Master)
Niveli i kualifikimit	Niveli 5
Eksperienca në punë	Po
Përshkrimi i eksperiencës	Mbi 3 vjet në të njëjtin pozicion pune
PËRGJEGJËSITË KRYESORE:	• Është përgjegjës për procesin e prodhimit dhe kualitetit; • Përcjell prodhimin duke filluar që nga dorëzimi i lëndës së pare; • Bashkëpunon me laborator lidhur me ngritjen e kualitetit; • Kontrollon prodhimin dhe paketimin dhe sugjeron për ndryshimin e parametrave; • Mban ditarë dhe raporte të punës dhe të dokumentacionit të arritur; • Për punën e vet i përgjigjet menaxherit të fabrikës
KËRKESAT E PROFILIT	• Diplomë Universitare në Kimi Industriale/Kimi Ushqimore; • Mbi 3 vite eksperiencë e mëparshme në pozicione të ngjashme në prodhim; • Njohuri të legjislacionit shqiptar për sigurinë ushqimore në prodhim; • Aftësi shumë të mira menaxheriale; • Njohuri të mira të paketës MS Office; • Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe bindëse. Të jete i gatshëm dhe i aftë të punojë në grup. • Të pëlqejë punën me njerëzit dhe të jetë entuziast. • Të jetë i dobishëm dhe i sjellshëm. • Te paturit e një paraqitje të denjë është kërkesë. • Te ketë aftësi shume të mira komunikuese.

SHITËS	
Bizneset	Dyqane
Sasia e vendeve të lira të punës	2

Rrethi	Dibër
Njësia administrative	Dibër
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat te pacaktuar
Koha e punës	Me kohe te plote
Paga	
Nga	25000
Deri	28000
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm i lartë (Gjimnaz)
Niveli i kualifikimit	Niveli 4
Eksperienca në punë	Jo
Përshkrimi i ekperiencës	
Përshkrimi i vendit të punës	Pozicioni Punës: kërkohet shitës në subjekt Kompetencat Profesionale: të ketë njohuri profesionale Detyrat/Përgjegjësitë: korrektese ne pune. Si Aplikohet: zyra e punese,
DETYRAT/PERGJEGJESITE KRYESORE	• Ndjekë udhëzimet e Administratorit; • Prezanton produktet e kërkuara nga klienti deri në realizimin përfundimtar të procesit të shitjes. • I përgjigjet pyetjeve të klientit. • Ka informacion të plotë rreth cilësive të produkteve që shet.
Aftësitë	Komunikimi dhe sjellja, ekselente

LLOGARITAR / ARKËTAR	
Bizneset	Fabrika / njësi shërbimi
Sasia e vendeve të lira të punës	2
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat të pacaktuar
Koha e punës	Me kohë të plotë
Paga	
Nga	46000
Deri	52000
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm i lartë (Profesional/I orientuar)

Niveli i kualifikimit	Niveli 5
Eksperienca në punë	Jo
Përshkrimi i ekperiencës	
Përgjegjësitë kryesore	• pranon dhe përpunon dokumentacionin parësor; • mban raporte mbi transaksionet e biznesit në llogaritë përkatëse; • përgatit urdhër-pagesat për pagat e punonjësve dhe detyrime të tjera; • të përgatisë vlerësimet e kostos për koston e produkteve të prodhuara ose të shitura; • llogarit dhe përgatit dokumentacionin për detyrimet e sipërmarrjes ndaj shtetit (tatime, taksa) dhe merr masa për pagimin në kohë të tyre • përgatit dokumente për zëvendësimin e faturave të shkatërruara të pranuara në arkë me të reja; • përgatit pasqyrat financiare; • mbani librin e llogarive të ndërmarrjes; • ndihmon në zbatimin e mjeteve moderne të kontabilitetit.
Aftësitë e dëshiruara	• Të ketë njohuri të mirë të legjislacionit aktual për taksat dhe kontabilitetin; • Të jetë familjar me procedurën për të punuar me arkë; • Të jetë i komunikueshëm; • Të mbajë marrëdhënie të ngushta dhe të vazhdueshme me stafin drejtues të ndërmarrjes

DISENJUES FAQESH WEB (IT)	
Bizneset	Fabrika
Sasia e vendeve të lira të punës	1
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat te pacaktuar
Koha e punës	Me kohë të plotë
Paga	
Nga	50000
Deri	600000
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm i lartë (Profesional/I orientuar)
Niveli i kualifikimit	Niveli 5
Eksperienca në punë	Po
Përshkrimi i eksperiencës	Mbi 3 muaj
PËRGJEGJËSITË KRYESORE:	• 3+ muaj përvojë në krijimin e faqeve në internet;

	• Kuptimi i tendencave dhe përparimeve aktuale në internet, me njohuri të qëndrueshme të Rrjedhës së Përgjegjshme të Web-it (RËD) dhe RËD • Ekspertizë në standardet moderne dhe praktikat më të mira • Njohuri të Hyrjes në Ueb • Përvojë e fortë me testimin dhe zhvillimin në shumë shfletues dhe lloje të pajisjeve (tableta, telefona inteligjentë etj.) Duke ruajtur një përvojë të qëndrueshme • Zhvilloni HTML / CSS / JS dhe modele për të ndërtuar faqe të përgjegjshme me një fokus të fortë në mirëmbajtjen, pajtueshmërinë ndërmjet shfletuesve dhe performancën • Shndërroni kompozimet e PSD-së në rritje - kërkohet përvojë me Photoshop dhe Illustrator • Qëndroni aktual në trendet më të fundit dhe teknologjitë në zhvillim brenda komunitetit UX / UI.
Aftësitë e dëshiruara	• Të punoni në mënyrë efektive brenda një procesi prodhimi të shkathët, të drejtuar nga afatet për të përfunduar projekte në internet me cikle të shpejta, përsëritëse • Punoni ngushtë me projektuesit, analistët e biznesit, • Të punoni në mënyrë efektive brenda një procesi prodhimi të shkathët, të drejtuar nga afatet për të përfunduar projekte në internet me cikle të shpejta, përsëritëse

PUNONJËS SOCIAL	
Biznese / organizata	Qendër Sociale
Sasia e vendeve të lira të punës	6
Rrethi	Dibër
Njësia administrative	Dibër
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat të pacaktuar
Koha e punës	Me kohë të plotë
Paga	
Nga	
Deri	
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i lartë (Profesional/I orientuar)
Niveli i kualifikimit	Niveli 5
Eksperienca në punë	Jo
Përshkrimi i eksperiencës	
Përgjegjësitë	• Të zbatojë grafiku dhe orarin e punës;

	• Të ruaj dhe të mirëmbajë pajisjet që i vihen në dispozicion për zhvillimin e projektit; • Të ruajë fshehtësinë e identitetit dhe të dhënave personale të përfitueses. • Të ofrojë një shërbim cilësor këshillues emocional ballë për ballë dhe nëpërmjet telefonit. • Të përgatisë raport vlerësimi psikologjik për rastet me probleme të theksuara. • Të referojë përfitueset të përfitojnë shërbime të tjera në institucione të tjera publike dhe OJF të tjera. • Të përgatisë për çdo fund muaj raportin narrativ për ecurinë e çdo përfituesi • Të ketë diplomë universitare në fushën e Shkencave Sociale, Dega Psikologji/Punë Sociale (Master Shkencor (Mr.sc) etj, dhe/ose të jetë një Psikolog i licensuar • Të ketë jo më pak se 3 vite punë në profesion • Të ketë kualifikime të veçanta në fushën profesionale (me çertifikata), ka përparësi profesionisti që ka kryer kualifikime dhe trajnime jashtë/brenda vendit në fushën e barazisë gjinore • Të ketë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve psiko-sociale për këtë target-grup • Të njohë mirë gjuhën angleze.
Aftësitë	• Të ketë diplomë universitare në fushën e Shkencave Sociale, Dega Psikologji/Punë Sociale (Master Shkencor (Mr.sc) etj, dhe/ose të jetë një Psikolog i licensuar; • Të ketë kualifikime të veçanta në fushën profesionale (me çertifikata), ka përparësi profesionisti që ka kryer kualifikime dhe trajnime jashtë/brenda vendit në fushën e barazisë gjinore.

PUNËTOR PËR SISTEMIM DHE PAKETIM MALLI PËR TRANSPORT	
Bizneset	Fabrika
Sasia e vendeve të lira të punës	2

Paga	
Nga	
Deri	
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm i ulët (9-vjeçar)
Niveli i kualifikimit	Niveli 1
Eksperienca në punë	Jo
Përshkrimi i eksperiencës	
Përshkrimi i vendit të punës	Pozicioni Punës: punëtore sistemim dhe paketim malli për transport Si Aplikohet: nga Zyra e Punës

PUNËTOR HORTIKULTURE	
Bizneset	Fermerë
Sasia e vendeve të lira të punës	1
Rrethi	Dibër
Njësia administrative	Dibër
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat të caktuar
Koha e punës	Me kohë të plotë
Paga	
Nga	30000
Deri	40000
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm i lartë (Gjimnaz)
Niveli i kualifikimit	Niveli 4
Eksperienca në punë	Po
Përshkrimi i eksperiencës	Mirëmbajtës në hortikulture
Përshkrimi i vendit të punës	Pozicioni Punës: mirëmbajtës për arrore, hortikulture

NËPUNËS FINANCE	
Bizneset	Ent Publik
Sasia e vendeve të lira të punës	1
Rrethi	Bashkia Bulqizë
Njësia administrative	Bulqizë
Të dhënat e punëdhënësit	
Emri i ndërmarrjes	Sh.A.Ujësjellësi Bulqizë
Veprimtaria ekonomike	E-3600 - Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë
Rrethi	Bashkia Bulqizë
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat te pacaktuar
Koha e punës	Me kohe te plote

Paga	
Nga	
Deri	
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Bachelor (3 vjeçar)
Niveli i kualifikimit	Niveli 5
Eksperienca në punë	Po
Përshkrimi i eksperiencës	Eksperienca përbën avantazh
Përshkrimi i vendit të punës	Pozicioni Punës: Nëpunës finance.

AGRONOM	
Bizneset	Fermerë
Sasia e vendeve të lira të punës	1
Rrethi	Dibër
Njësia administrative	Dibër
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat te pacaktuar
Koha e punës	Me kohe te plote
Paga	
Nga	
Deri	
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Master shkencor (3+2 vjet)
Niveli i kualifikimit	Niveli 7
Eksperienca në punë	Po
Përshkrimi i eksperiencës	te kenë përvojë në punë të paktën 5 vjet
Përshkrimi i vendit të punës	Pozicioni Punës: Kandidati duhet të zotërojë një diplomë të nivelit të dyte në Agronomi. Të ketë aftësi të shkëlqyera nga Teknologjia e përpunimit të fruta-perimeve dhe Teknologjia ushqimore. Të ketë eksperiencë në zhvillimin e bujqësisë dhe i sistemit të agrobiznesit në tërësi. Kompetencat Profesionale: Njohja e një gjuhe te huaj përbën avantazh.

PUNËTOR KRAHU	
Bizneset	Fabrika
Sasia e vendeve të lira të punës	1
Të dhënat e punëdhënësit	
Emri i ndërmarrjes	ARDAS
Veprimtaria ekonomike	B-0892 - Nxjerrja e torfave
Rrethi	Bashkia Bulqizë
Kushtet e punësimit	

Kohëzgjatja e kontratës	Me afat te pacaktuar
Koha e punës	Me kohë të plotë
Paga	
Nga	28000
Deri	38000
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm i ulët (9-vjeçar)
Niveli i kualifikimit	Niveli 1
Eksperienca në punë	Jo
Përshkrimi i eksperiencës	
Përshkrimi i vendit të punës	Pozicioni Punës: punëtor krahu Kompetencat Profesionale: të jetë i aftë në punë Detyrat/Përgjegjësitë: të mbajë përgjegjësi në punë

EDUKATORË NË KOPSHTE	
Bizneset	Ent Publik
Sasia e vendeve të lira të punës	1
Të dhënat e punëdhënësit	
Emri i ndërmarrjes	Bashkia Mat
Veprimtaria ekonomike	O-8411 - Aktivitete të administratës së përgjithshme publike
Rrethi	Bashkia Mat
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat te pacaktuar
Koha e punës	Me kohe te plote
Paga	
Nga	28000
Deri	38000
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Bachelor (3 vjeçar)
Niveli i kualifikimit	Niveli 4
Eksperienca në punë	Jo
Përshkrimi i eksperiencës	
Përshkrimi i vendit të punës	Pozicioni Punës: Edukatore kopshti Kompetencat Profesionale: të ketë eksperiencë pune dhe të jetë i aftë Detyrat/Përgjegjësitë: të mbajë përgjegjësi

MONTUES INSTRUMENTESH	
Bizneset	Fabrika
Sasia e vendeve të lira të punës	1
Kushtet e punësimit	

Kohëzgjatja e kontratës	Me afat te pacaktuar
Koha e punës	Me kohe te plote
Paga	
Nga	26000
Deri	32000
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm (Gjimnaz)
Niveli i kualifikimit	Niveli 4
Eksperienca në punë	Po
Përshkrimi i ekperiencës	
Përshkrimi i vendit të punës	Pozicioni Punës: montues Detyrat/Përgjegjësitë: te jene korrekt ne pune Si Aplikohet: në Zyrën e Punës

LABORANT TEKNOLOG	
Bizneset	Fabrika
Sasia e vendeve të lira të punës	2
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat te pacaktuar
Koha e punës	Me kohe te plote
Paga	
Nga	26000
Deri	36000
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Bachelor (3 vjeçar)
Niveli i kualifikimit	Niveli 5
Eksperienca në punë	Po
Përgjegjësitë	• Zbatimin e planit të parashikuar të prodhimit, • Te jetë i përgjegjshëm në orar të punës, • Raporton në baza javore, • Të jetë në gjendje për të maksimizuar produktivitetin dhe efikasitetin si dhe arritjen e objektivave te caktuara të prodhimit. • Përgjegjës për zhvillimin, teknologjinë e prodhimit dhe kontrollin e cilësisë. • Kryen hulumtime bazë dhe kërkime të reja të produkteve dhe zhvillim e tyre.

	• Zhvillon metoda dhe sisteme të reja dhe të përmirësuara për përpunimin e produkteve, prodhimin dhe kontrollin e cilësisë. • Zhvillon standardet ushqimore, rregulloret e sigurisë dhe sanitare, dhe bën menaxhimin e te gjitha proceseve. • Inspektimi i proceseve të prodhimit dhe kualitetit të produkteve. • Siguron që procesi i prodhimit dhe dorëzimi i produkteve realizohet dhe mirëmbahet sipas standardeve. • Detyra të tjera të përcaktuara nga mbikëqyrësi direkt që ndërlidhen me procesin e punës.
Aftësitë	• Të jetë pozitiv dhe i motivuar për punë, • Të ketë patentë shoferin kat. B, • Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi, • Të jetë në gjendje të punojë në mënyrë të pavarur apo në grup, • Të jetë fleksibël dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve, • Të jenë korrekt në punë

MAGAZINIER	
Bizneset	Fabrika
Sasia e vendeve të lira të punës	1
Kushtet e punësimit	
Kohëzgjatja e kontratës	Me afat te pacaktuar
Koha e punës	Me kohe te plote
Paga	
Nga	34000
Deri	40000
Kërkesa të përgjithshme	
Arsimimi	Arsim i mesëm i lartë (Gjimnaz)
Niveli i kualifikimit	Niveli 4
Eksperienca në punë	Jo
Përshkrimi i eksperiencës	
Përgjegjësitë kryesore:	• Është përgjegjës për vendosjen, sistemimin dhe administrimin e gjithë materialeve që ndodhen në magazine; • Bën inventarizimin e materialeve, dokumenton çdo lëvizje në magazinë (hyrje ose dalje), si dhe transferon materiale të kompanisë sipas një kërkese të aprovuar nga administratori/ja i kompanisë; • Është përgjegjës për ruajtjen e vlerave materiale sipas kushteve teknike që kërkon secili prej tyre;

	• Është përgjegjës për rregullsinë dhe ligjshmërinë e plotësimit të të gjithë dokumentacionit të hyrjes (marrjes në dorëzim) apo daljes (dorëzimit) të materialeve, si fletëhyrje, fletëdalje, procesverbale etj.; • Mbikëqyr aktivitetin dhe shpërndan detyrat për punëtorët e magazinës; • Plotëson ditarin e magazinës për çdo lëvizje, hyrje-dalje dhe dokumentet dhe kartelat përkatëse; • Mban procesverbale për çdo incident, thyerje, dëmtim apo shpërdorim; • Mban inventarin e gjendjes së mallit në magazinë dhe përgatit raporte; • Bën raportime ditore tek eprori i drejtpërdrejtë.
Kërkesat e profilit	• Të jetë korrekt, dhe të aftësi të mira inventarizimi; • Të ketë njohuri të mira të programit financiar, programe menaxheriale); • Aftësi shumë të mira komunikuese , bashkëpunuese dhe raportuese